

VENDIM
Nr.788, datë 26.11.2003

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.426, DATË 9.7.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË SHËRBIMIT TË VARRIMIT
PËR SHTETASIT SHQIPTARË, QË VDESIN BRENDA DHE JASHTË SHTETIT"

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 55 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.426, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

"3. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, me fonde të Buxhetit të Shtetit, organizon shërbimin e transportit të kufomave dhe të eshtrave vetëm për rastet e fatkeqësive të ndodhura jashtë territorit të vendit, për personat që janë dërguar me shërbim ose mjekim shëndetësor nga shteti, për punonjësit e përfaqësive diplomatike, si dhe për rastet e veçanta, sipas kërkesës së bërë nga institucione, njësi të qeverisjes vendore apo shoqata të ndryshme.

Për shtetasit shqiptarë, që vdesin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kur shpenzimet e transportit përballohen nga familjarët e të ndjerit, Buxheti i Shtetit rimbursen një pjesë të këtyre shpenzimeve.

Rastet e veçanta dhe masa e kontributit të shtetit në përballimin e shpenzimeve të varrimit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të Ministrit të Financave."

2. Në të gjithë vendimin emërtimi "Ministria e Punëve Publike dhe Transportit", zëvendësohet me "Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit" dhe emërtimi "Këshilli i rrethit" zëvendësohet me "Qark".

3. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano